

## Buletini i **NFFIS dhe ECO-DRR** për Ballkanin Perëndimor

Projekti për Ndërtimin e kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR  
Mars 2021 - Shkurt 2026

### Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR

Qëllimi i këtij projekti është të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve pyjore dhe katastrofave të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR.

### Seminari Regjional

Në Maqedoninë e Veriut, e cila kufizohet me Kosovën në jug, Sistemi i Informimit për zjarret Pyjore i Maqedonisë (MKFFIS) u zhvillua në vitin 2014 me mbështetjen e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA). Sistemi po përdoret për menaxhimin e zjarreve pyjore ndërsa po zgjerohet. Për më tepër, një projekt pasardhës i JICA filloi në 2017, në të cilin modelet e Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive (Eco-DRR) të bazuara në natyrë janë në zhvillim e sipër në tre vende. Në Maqedoninë e Veriut u mbajt një seminar regjional me pjesëmarrjen e 11 zyrtarëve qeveritarë nga Kosova, 13 zyrtarëve qeveritarë nga Mali i Zi me gjithsej rreth 40 zyrtarë duke përfshirë edhe të tjerë, me qëllimin kryesor për të mësuar nga përvoja e zhvillimit dhe funksionimit të MKFFIS dhe Zhvillimi i modelit Eco-DRR.

Ditën e parë, pas prezantimit të MKFFIS nga një zyrtar i qeverisë së Maqedonisë së Veriut, u mbajt një diskutim në grup. Pjesëmarrësit diskutuan të dhënat që do të instalohen në Sistemin Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) që do të zhvillohet në Kosovë dhe Mal të Zi. Në ditën e dytë, u bë një vizitë për të vëzhguar modelin Eco-DRR (ruajtja dhe mbjellja në pyje) në terren. Pjesëmarrësit komentuan se, duke kuptuar MKFFIS dhe Eco-DRR, ata kishin një pasqyrë më konkrete të aktiviteteve në të cilat duhet të fokusohen për zhvillimin e NFFIS dhe Eco-DRR.



### Bashkëpunimi Regjional (Kosovë-Mal i Zi-Maqedoni e Veriut)




Para se të përmbliiden përkufizimet dhe konceptet e NFFIS që do të zhvillohen në Kosovë dhe Mal të Zi, është e nevojshme të krijohen udhëzime që përfshijnë përkufizimet e fatkeqësive. Të dy vendet kanë mbajtur disa takime ndërmjet homologëve për tu këshilluar me Dr. Stevko Stefanoski nga Qendra për Menaxhimin e Krizave (CMC), i cili luajti një rol kyq në zhvillimin e MKFFIS në Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, përfaqësuesit e Kosovës dhe Malit të Zi kanë nënshkruar një Procesverbal Diskutimi (RD) ku ceket se informacionet do të shkëmbehen në mënyrë aktive në NFFIS dhe Eco-DRR. Pritet që bashkëpunimi regjional të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Metoda Eco-DRR për parandalimin e orteqeve

Projekti përfshin një aktivitet për të demonstruar qasjen Eko-DRR - pyjet për parandalimin e orteqeve në kontekstin e katastrofës së ortekut që ndodhi në shkurt 2012 në fshatin Restelice, Komuna e Dragashit, duke shkaktuar 10 humbje jetësh. Projekti e zgjodhi këtë pjerrësi si objektiv të aktivitetit të Projektit, duke marrë parasysh rezultatet e sondazheve në terren dhe diskutimeve me homologët të mbajtura vitin e kaluar. Në tetor 2021, Projekti kreu një studim me dron në pjerrësinë e synuar dhe mori të dhëna topografike për të projektuar pyje për parandalimin e orteqeve dhe fotografi ajrore për të konfirmuar mbulueshmërinë e vegjetacionit.

Edhe pse puna e mbjelljes do të kryhet nga Projekti për të parandaluar ndodhjen e orteqeve, nuk ka gjasa që fidanet e reja të jenë mjaft efektive për parandalim. Prandaj, po shqyrtojmë një dizajn në të cilin do të vendosen trekëmbësh prej druri për të plotësuar efektin parandalues derisa fidanet të rriten. Detajet e projektimit do të finalizohen përmes diskutimit me homologët gjatë takimit të ardhshëm.



Harta topografike e shpatit të synuar në fshatin Restelice, e krijuar nga të dhënat e fituara përmes dronit (majtas)

Vizatim konceptual i trekëmbëshit prej druri (marrë nga një raport Austriak mbi ortekun) (djathtas)

## Takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët Kordinues (KPK)

Takimi i Dytë i Komitetit të Përbashkët Koordinues (KPK) është mbajtur për Kosovën më 7 dhjetor 2021, nën kryesimin e z. Alush Beqiri, Drejtor i Departamentit të Parandalimit, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Për Malin e Zi, ajo u mbajt më 15 dhjetor 2021 përmes takimit online, nën kryesimin e z. Ljuban Tmusic, Shef i Departamentit për Mbrojtjen Civile dhe Drejtorisë për Shpëtim dhe Mbrojtje dhe Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë. Çdo takim i KPK-së përfshinte një përfaqësues nga selia qendrore e JICA-s, Zyra e JICA-së për Ballkanin dhe Ekipi i Ekspertëve të JICA-s. Në çdo takim të KPK-së, u prezantua një përmbledhje e aktiviteteve të Projektit që u zbatuan në vitin 2021, u shkëmbyen pyetje dhe u zhvilluan diskutime. Më tej, u miratuan planet për Projektin në vitin 2022.



←  
Kosovë

→  
Mal i Zi



## Përmbledhje e Aktiviteteve

### Kosovë Rezultati 1

- Përfundimi i metodologjisë (Udhëzuesi)
- Diskutimi i përmbajtjes së sistemit NFFIS
- Shqyrtimi i shtresave për NFFIS

### Kosovë Rezultati 2

- Projektimi i pyllit për parandalimin e orteqeve
- Studimi i përmbajtjes së aktiviteteve pyjore kundër erërave

### Mal i Zi Rezultati 1

- Diskutimi i përmbajtjes së sistemit NFFIS
- Rishikim i shtresave NFFIS

### Mal i Zi Rezultati 2

- Vrojtimi në terren i pyllit bregdetar
- Diskutimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik

Web-faqja e Projektit  
tani është aktive!  
Ju lutem shiheni!

